

Tiranë, më 31.10.2023

Lënda: Informacion për misionin e auditimit për Partinë "Bashkimi Demokrat Shqiptar"

**Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve
Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 544, datë 22.05.2023, jemi caktuar me cilesine e ekspertit kontabël të regjistruar (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2022 nga Partia "Bashkimi Demokrat Shqiptar", të deklaruara në raportin financiar vjetor te vitit 2022 pranë KQZ-së për këtë periudhë"

Menjeherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, më datë 27.09.2023, vendosa komunikimin zyrtar me kryetarin e partisë politike " Bashkimi Demokrat Shqiptar", z. Ylber Valteri për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit të letrës rekomande, në adresën e selisë së partisë siç ishte përshkruar në adresën që na dërgoi KQZ-ja.

Në komunikimin zyrtar me kryetarin të Partisë, z. Ylber Valteri deklaroi se : "Bashkimi Demokrat Shqiptar" për vitin kalendarik 2022

- Nuk ka patur hyrje nga asnje burim të ardhurash, si kuotat e antarësise, financime nga buxheti i shtetit, financime nga donatore te huaj dhe vendas, hua, burime në natyre apo kompesime shpenzimesh.
- Nuk ka pasur burime materiale dhe financiare të trashguara nga viti 2021.
- Nuk ka realizuar asnje blerje mallrash e shërbime për llogari të partisë nga operatorë tregtarë dhe individ dhe nuk kemi berë pagesa ndaj tyre.
- Nuk ka pasur të punësuar dhe për rrjedhim shpenzime për paga dhe sigurime shoqerore e shendetesore.
- Nuk ka kontrata për ambiente me qera apo huapërdorje.
- Ka të hapur llogari bankare ne bankat qe veprojne ne shqiperi dhe jashte saj, por nuk ka kryer asnje tarnsaksion financiar.

Në kushtet e mungeses së transaksioneve ekonomike dhe financiare, Partia "Bashkimi Demokrat Shqiptar" ka dorëzuar Pasqyrat Financiare me vlerë zero pranë KQZ-së.

Si konkluzion për shkak të rrethanave të shpjeguara më sipër, nuk përbëjnë auditim sipas Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit, ne nuk mund të shprehim asnjë opinion për fondet e përftuara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2022 nga Partia "Bashkimi Demokrat Shqiptar".

Audituesi Ligjor(Ekspert Kontabël i Regjistruar)

Sherife Hoxha

